



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 07 prot.

Kamëz, më 27.01. 2020

V E N D I M

Nr. 07 . Datë 27.01. 2020

P Ë R

MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA TË AMBJENTEVE BRENDË
BASHKISË KAMËZ TË LLOJIT “NDËRTESE” ME SIPËRFAQE “29.7 m²”, NË
PRONËSI TË BASHKISË KAMËZ

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më datë 27.01. 2020, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin nr.07, datë 16.01. 2020, në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2 shkronja “c”, nenit 54, shkronja “c” dhe nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 28, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, vendimin nr 775, datë 05.09.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz”, Kreut II, të vendimit nr.54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve , procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, Udhëzimit nr. 13, datë 26.04.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar”, Këshilli Bashkiak Kamëz:

V E N D O S I

1. Miratimin në parim të dhënies me qira të ambjenteve brenda Bashkisë Kamëz të llojit “ndërtesë”, me sipërfaqe 29.7 m², zona kadastrale 2066, nr. i pasurisë 92/57, Kamëz, në pronësi të Bashkisë Kamëz.
2. Planimetria e ambjentit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, paraqitet në Aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Periudha e dhënies me qira të përcaktohet në kontratën që do të lidhet ndërmjet subjektit dhe Bashkisë Kamëz



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, si dhe lidhjen e kontratës së qirasë.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor të **Prefektit të Qarkut Tiranë**.

K R Y E T A R
Hysen KOLDASHI

